



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 273/25 Datë: 20.03.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 135 të mbajtur më 10.03.2025, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, për periudhën **tre (3) vjeçare**, (1 tetor 2025 - 30 shtator 2028):
 - *Teknologji, BSc, 180 R, (me 2 specializime), me kuotën maksimumi 40 studentë për vit akademik;*
 1. *Inxhinieri mjedisore dhe*
 2. *Inxhinieri kimike.*
- II. Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë që deri me 30 shtator 2025, të dorëzojnë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim Planin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë të raportoj dhe arsyetoj në AKA çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit brenda 90 ditëve. Lista me ndryshim të bartësve aprovohet me vendim nga KShC.
- V. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë brenda afatit ligjor ka parashtuar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
I.	<i>Teknologji, BSc, 180 R, (me 2 specializime);</i> 1. <i>Inxhinieri mjedisore dhe</i> 2. <i>Inxhinieri kimike.</i>	Mehush Aliu Flora Ferati Faruk Hajrizi Ismet Mulliqi Besire Cena

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit AKA ka organizuar vizitat në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë me ekspertë të jashtëm ndërkombëtarë të akreditimit.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr. 03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelor dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Për programin e studimit; Teknologji BSc 180 R, (me 2 specializime) 1. Inxhinieri mjedisore dhe 2. Inxhinieri kimike, vizita me ekipin e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Francisco Javier Farfan, Sanja Kalambura dhe Issabek Muratov është organizuar më 30.01.2025 ku gjatë vlerësimit ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit dhe Substancialisht katër (4) fusha të standardeve dhe Pjesërisht një (1) fushë të standardeve, të përcaktuara me Rregullorja (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelor dhe Master.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 135-të, të mbajtur më datë 10.03.2025, ka shqyrtuar dokumentacionin relevant të akreditimit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë dhe duke u bazuar në vlerësimet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit "Isa Boletini" Mitrovicë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.